



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Albchrome Holding SHPK dhe filialeve të saj nga shoqëria Yildirim International Mining Investments B.V.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 464 Prot., i AK, datë 25.10.2021 “Depozitim i dokumenteve shoqëruese të njoftimit në lidhje me transaksionin midis Yildirim International Mining Investments B.V. dhe Balkan Finance Investment Group SHPK, nëpërmjet të cilës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë Albchrome Holding SHPK dhe filialeve të saj nga shoqëria Yildirim International Mining Investments B.V.

Palët në marrëveshje janë:

Blerësi: Yildirim International Mining Investments B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Hollandës, pjesë e Grupit Yildirim, grup që operon në një numër të madh industrish si: metalurgji dhe miniera, qymyre dhe coke, energji, plehra kimike ose fertilizues dhe kimikate, menaxhim porti, transport, logjistik etj.

Grupi Yildirim nuk është aktiv dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Shitësi: Balkan Finance Investment Group SHPK, është një shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt të veprimtarisë: investimi në instrumente financiare; investime në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme); ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose të tretë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Target: Albchrome Holding SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: menaxhimi, aktivitetet mbështetëse për industrinë e minierave, shërbimet për mineralet jo-metalike etj. Albchrome Holding ka dy filiale në pronësi të plotë Albchrome SHPK dhe Vllahen Mining SHPK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.